

Në bazë të nenit 24, paragrafi (1), pika 1), nënparagrafi 9 dhe nenit 37 paragrafi (8) të Ligjit të Energjetikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 236/22), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 4 dhjetor 2023, solli këto

RREGULLA PËR VEPRIM SIPAS ANKESAVE DHE PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda

Neni 1

Me këto rregulla rregullohet procedura, shumta dhe mënyra e mbulimit të shpenzimeve në procedurat sipas ankesave dhe për zgjidhjen e kontesteve.

Ankesat dhe kontestet

Neni 2

- (1) Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat Komunale (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës), vendos sipas ankesave të parashtruara nga:
 - 1) përdoruesit e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, të gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës dhe të energjisë termike:
 - kundër akteve të operatorëve përkatës, përmes të cilëve refuzohet qasja ose lidhja në sistemin përkatës, ndërsa sa i përket energjisë termike edhe kundër akteve të operatorit përkatës, me të cilat refuzohet kërkesa për lidhje, si dhe kundër akteve, me të cilat përcaktohet shumta e kompensimit dhe kushtet e tjera për lidhje dhe në raport me energjinë termike dhe kundër akteve, me të cilat përcaktohet shumta e kompensimit dhe kushtet e tjera për shkëputje,
 - për shkak të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimit ose ndërprerjes së dërgesës së energjisë elektrike, gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës dhe të energjisë termike, nga dhe në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike ose të gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës,
 - 2) konsumatorët kundër furnizuesve, të cilët kanë detyrim të mundësojnë shërbim publik ose universal, si dhe kundër furnizuesve në rastin e fundëm në lidhje me:
 - cilësinë e shërbimit të furnizimit,
 - kufizimin ose pamundësimin e të drejtës për ndërrimin e furnizuesit,
 - përlllogaritjen e energjisë së shpenzuar dhe shumën e faturës,
 - 3) ushtruesit e veprimtarive energjetike dhe nga konsumatorët, kundër një akti të vetëm të operatorit të tregut përkatës të energjisë, me të cilin refuzohet kërkesa për regjistrim në regjistrin përkatës ose vendoset për të drejtat dhe detyrimet, të cilat rrjedhin nga pjesëmarrja në tregun përkatës,
- (2) Komisioni Rregullator i Energjetikës vendos në procedurë për zgjidhjen e kontesteve të shkaktuara nga realizimi i marrëveshjeve mes ushtruesve të veprimtarive energjetike, ushtruesve të veprimtarive

energjetike dhe konsumatorëve, si dhe operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe përdoruesve të atyre sistemeve, kur për atë janë marrë vesh palët kontraktuese.

II. VENDIMARRJA SIPAS ANKESAVE

Parimet e procedurës

Neni 3

Në procedurën për vendimmarrje sipas ankesave, Komisioni Rregullator i Energjetikës i zbaton parimet nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Pala në procedurën për vendimmarrje sipas ankesës

Neni 4

- (1) Pala, sipas kërkesës së të cilës nisët procedurë, është:
 - 1) përdoruesi i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, të gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës dhe të energjisë termike,
 - 2) konsumatori i cili furnizohet nga furnizuesi, i cili ka për detyrë të sigurojë shërbimin publik ose universal, si dhe nga furnizuesi në rastin e fundëm dhe
 - 3) ushtruesi i veprimtarisë energjetike ose konsumatori, i cili ka të drejtë të marrë pjesë në tregun e llojit përkatës të energjisë.
- (2) Pala, kundër të cilës është nisur procedura është ushtruese e veprimtarisë së rregulluar energjetike ose ushtruese e veprimtarisë energjetike, e cila ka për detyrë të mundësojë shërbimin publik ose universal ose ushtruese e veprimtarive energjetike-transport i naftës së papërpunuar përmes naftëpërçuesit, respektivisht të transportit të derivateve të naftës përmes produktpërçuesit.

Ankesa

Neni 5

- (1) Ankesa është parashtrësë e palës nga neni 4 paragrafi (1) i këtyre rregullave, e dërguar deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës me qëllim të realizimit të ndonjë të drejte të përcaktuar në Ligjin e Energjetikës, si dhe në rregullat dhe dispozitat e sjella ose të miratuara nga Komisioni Rregullator i Energjetikës.
- (2) Ankesa parashtrohet kundër:
 - 1) aktit të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, të gazit natyror dhe të energjisë termike:
 - me të cilin refuzohet qasja, lidhja te sistemi përkatës,
 - me të cilin përcaktohet shuma e kompensimit dhe kushtet e tjera për lidhje, ose
 - me të cilin refuzohet kërkesa për kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhojë e kufizimit ose ndërprerjes së dërgesës së energjisë elektrike, të gazit natyror dhe të energjisë termike, nga dhe në sistemet përkatëse,

- në raport me energjinë termike dhe kundër akteve të operatorit përkatës, me të cilat refuzohet kërkesa për shkëputje dhe kundër akteve, me të cilat përcaktohet shuma e kompensimit dhe kushtet e tjera të shkëputjes.
- 2) konsumatorit, i cili ka për detyrë të mundësojë shërbimin publik ose universal, si dhe kundër furnizuesit në rastin e fundëm në lidhje me:
 - cilësinë e shërbimit të furnizimit,
 - kufizimin ose pamundësimin e të drejtës për ndërrimin e furnizuesit dhe
 - përlllogaritjen e energjisë së shpenzuar si dhe shumën e faturës.
 - 3) vendimit të operatorit të tregut përkatës të energjisë për hedhjen poshtë ose refuzimin e kërkesës për regjistrim në tregun e energjisë, si dhe hedhjen poshtë apo refuzimin e kërkesës për marrjen e statusit të palës përgjegjëse të balancimit,
 - 4) aktvendimit për refuzimin e kërkesës për qasje deri te naftëpërçuesi, respektivisht deri te produktpërçuesi, të sjellë nga ushtruesi i veprimtarive energjetike - transport të derivateve të naftës përmes produktpërçuesit dhe
 - 5) vendimit të operatorit të tregut përkatës të energjisë, përmes të cilit vendoset për të drejtat dhe detyrimet, të cilat rrjedhin nga pjesëmarrja në tregun përkatës.
- (3) Ankesa parashtrohet edhe kur ushtruesi i veprimtarisë energjetike nga paragrafi (2) i këtij neni, në afatin e përcaktuar nuk do ta sjellë aktin nga paragrafi (2) pika 1) ose vendimin nga paragrafi (2) pika 3) ose aktvendimit nga paragrafi (2) pika 4) e këtij neni, respektivisht kur nuk do të veprojë sipas parashtrësës në raport me rastet nga paragrafi (2) pika 2) e këtij neni.
 - (4) Ankesa parashtrohet edhe kur do të shkaktohet dëmi për shkak të dërgesës së ulur apo të ndërprerjes së dërgesës së energjisë elektrike, të gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës dhe të energjisë termike, nga dhe në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të naftës së papërpunuar dhe të derivateve të naftës, sa i përket akteve të operatorëve përkatës për përcakimin e shumës së kompensimit për dëmin e shkaktuar, bazën për përcaktimin e dëmit, mosveprimin sipas kërkesës për dëmshpërblim dhe hedhjen poshtë të kërkesës për dëmshpërblim.

Përmbajtja e ankesës

Neni 6

- (1) Pala e parashtron ankesën në formë të shkruar ose elektronike.
- (2) Ankesa përmban:
 - 1) Të dhënat për parashtruesin e ankesës (emri dhe mbiemri dhe adresa e personit fizik, respektivisht emri dhe selia e personit juridik, të shkruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut)
 - 2) Të dhënat për aktin ose aktivitetin, kundër të cilit parashtrohet ankesa, përfshirë edhe datën e sjelljes së aktit dhe datën e pranimit të aktit nga parashtruesi i ankesës.
 - 3) Arsyen dhe qëllimin për parashtrimin e ankesës,
 - 4) Dëshmitë, shtojcat dhe të dhënat e tjera.
- (3) Ankesa në formë të shkruar duhet të nënshkruhet nga vetë parashtruesi i ankesës.
- (4) Ankesës i bashkëngjitet edhe akti, kundër të cilit parashtrohet ankesa ose ndonjë dëshmi tjetër se parashtruesi i ankesës i ka përdorur të gjitha mjetet për realizimin e të drejtës së tij nëpërmjet procedurave të vendosura nga ushtruesi i veprimtarisë energjetike, kundër aktit të të cilit parashtrohet

ankesa, me përjashtim të rasteve nga neni 5 paragrafi (2) pika 2) dhe neni 5 paragrafi (3) i këtyre rregullave.

- (5) Ankesa duhet të jetë mjaft e qartë për t'i mundësuar Komisionit Rregullator të Energjetikës që ta ndërmarrë veprimin e kërkuar.

Parashtrimi i ankesës

Neni 7

- (1) Ankesa parashtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur:
 - 1) Parashtruesi i ankesës e ka fituar aktin, ose
 - 2) Ka skaduar afati i përcaktuar, kur është dashur të sillet akti, ose
 - 3) Parashtruesi i ankesës ka marrë vesh për veprën e kryer, kundër të cilës parashtrohet ankesa.
- (2) Ankesa parashtrohet në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës, përmes postës së rekomanduar ose përmes postës elektronike.
- (3) Nëse ankesa parashtrohet në formë elektronike, dokumentacioni bashkëngjitur dërgohet në formë të skanuar.
- (4) Data e pranimit të ankesës është data:
 - 1) Kur është pranuar ankesa në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës, ose
 - 2) E shënuar në dërgesën e rekomanduar përmes postës, ose
 - 3) Ankesa në formë elektronike është vendosur në sistemin e informacionit të Komisionit Rregullator të Energjetikës.

Komisioni për veprim sipas ankesave

Neni 8

- (1) Sipas ankesës vepron komisioni përkatës, i formuar me aktvendim nga Komisioni Rregullator i Energjetikës (në tekstin e mëtejshëm: komisioni), i formuar nga pesë anëtarë.
- (2) Mandati i anëtarëve të komisionit është tre vite.
- (3) Tre anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar i komisionit, emërohen nga anëtarët e Komisionit Rregullator të Energjetikës, ndërsa dy anëtarët e tjerë emërohen nga të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit Rregullator të Energjetikës.
- (4) Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës emëron sekretarin e komisionit nga rradhët e të punësuarve në shërbimin profesional, i cili do t'i kryejë punët administrative - teknike për nevojat e komisionit.
- (5) Me kërkesë të tij, ose me kërkesë të palës në procedurë, anëtari i komisionit mund të tërhiqet nga procedura sipas një ankese të përcaktuar, nëse përcaktohet se ka interes personal, dhe/ose raport familjar ose afarist me njërin prej palëve në procedurë ose nëse ekzistojnë rrethana që japin shkas për dyshim të bazuar për paanshmërinë ose pavarësinë e tij.
- (6) Pasi të kuptojë se ekziston njëra prej arsyeve për tërheqje, nga neni (5) i këtij neni, anëtari i komisionit e ndërpret punën mbi atë lëndë dhe për këtë e njofton kryetarin e Komisionit Rregullator të Energjetikës.

- (7) Pala në procedurë parashtron kërkesë për tërheqjen e anëtarit të komisionit, menjëherë pasi të njoftohet se ekziston njëra prej arsyeve për tërheqje nga paragrafi (5) i këtij neni, ndërsa më së voni deri në sjelljen e aktvendimit sipas ankesës.
- (8) Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës vendos sipas kërkesës për tërheqje dhe në rast të miratimit të kërkesës, e përcakton zëvendësimin e anëtarit të komisionit, i cili ka kërkuar, apo për të cilin është kërkuar tërheqje.
- (9) Komisioni vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

Veprimi sipas ankesës

Neni 9

- (1) Komisioni e shqyrton ankesën dhe nëse përcakton se është me kohë, e lejuar dhe e plotë, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të ankesës në Komisionin Rregullator të Energjetikës e dërgon ankesën dhe dokumentacionin bashkëngjitur, deri te pala kundër të cilës është nisur procedura.
- (2) Nëse pala, kundër të cilës është nisur procedura, në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur nuk deklarohet sipas ankesës, komisioni e nis procedurën dhe e përcakton gjendjen faktike në bazë të dëshmive të dërguara dhe të dhënave të përmbajtura në ankesë dhe në dokumentacionin bashkëngjitur.
- (3) Nëse pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur, komisioni përcakton se i njëjti nuk është i plotë, respektivisht se nuk i përmban elementet nga neni 6 paragrafi (2) i këtyre rregullave, dhe dërgon njoftim deri te parashtruesi i ankesës për plotësimin ose qartësimin e të njëjtit. Parashtruesi i ankesës duhet që, në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të njoftimit, të veprojë sipas të njëjtit.

Veprimi sipas ankesës së lëshuar jashtë afatit, të palejuar ose të paplotë

Neni 10

- (1) Komisioni i propozon Komisionit Rregullator të Energjetikës që me aktvendim ta hedhë poshtë ankesën nëse gjatë shqyrtimit përcaktohet se ankesa është:
 - 1) Jashtë afatit, respektivisht nuk është dërguar në afatin e përcaktuar në nenin 7 paragrafi (1) të këtyre rregullave;
 - 2) E palejuar, respektivisht lënda e ankesës nuk i referohet aktit ose veprimit në lidhje me çështjet e cekura në nenin 5 paragrafi (2) dhe paragrafi (4) të këtyre rregullave, ose është parashtruar nga personi i paautorizuar, ose parashtruesi i ankesës nuk e ka dërguar aktin, kundër të cilit parashtrohet ankesa, ose ndonjë dëshmi se i ka përdorur të gjitha mjetet për realizimin e të drejtës së tij nëpërmjet procedurave të vendosura nga pala, kundër të cilës është nisur procedura dhe
 - 3) E paplotë, respektivisht nuk i përmban elementet nga neni 6 paragrafi (2) i këtyre rregullave ose nuk është e qartë, ndërsa pasi të përcaktohet se parashtruesi nuk ka vepruar në përputhje me njoftimin, për të cilin është udhëzuar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, ta plotësojë ose ta qartësojë ankesën.
- (2) Nëse ankesa i referohet çështjeve, për të cilat Komisioni Rregullator i Energjetikës nuk është i autorizuar që të veprojë, në aktvendimin me të cilin hidhet poshtë ankesa si e palejuar, pala i referohet organit të autorizuar.
- (3) Aktvendimi për hedhjen poshtë të ankesës, i sjellë nga Komisioni Rregullator i Energjetikës është final dhe nuk mund të nisët kontest administrativ kundër tij.

Seanca e komisionit

Neni 11

- (1) Komisioni punon dhe e zbaton procedurën në seancën që e thërret dhe kryetari i komisionit udhëheq me të.
- (2) Seanca e komisionit mbahet në afat prej 15 ditësh nga skadimi i afatit nga neni 9 paragrafi (2) i këtyre rregullave.
- (3) Komisioni vendos në bazë të dëshmive të dërguara me shkrim dhe të dhënave të tjera të nevojshme për përcaktimin e gjendjes faktike.
- (4) Nëse gjatë procedurës, komisioni vlerëson se duhet të dërgohen dëshmi dhe fakte shtesë për përcaktimin e saktë të gjendjes faktike, do t'i detyrojë palët që në afat prej dhjetë ditësh t'i dërgojnë dëshmitë dhe faktet shtesë.
- (5) Për përcaktimin e drejtë të gjendjes faktike, komisioni mundet që me njoftim paraprak, deri te palët, të bëjë këqyrjen e hapësirave, impjanteve, pajisjeve, instalimeve dhe dokumentacionin e palëvetë cekura në ankesë, ndërsa palët duhet ta mundësojnë dhe të mos e pengojnë këqyrjen. Për gjendjen e përcaktuar nga këqyrja, përgatitet procesverbal.
- (6) Sekretari mban procesverbal për rrjedhën e seancave të komisionit, të cilin e nënshkruan kryetari dhe anëtarët e komisionit dhe sekretari, ku posaçërisht theksohet:
 - 1) koha dhe vendi i mbajtjes së seancës,
 - 2) emrat dhe anëtarët e komisionit,
 - 3) emrat, respektivisht emri i palëve,
 - 4) të dhënat për lëndën e vendimarrjes dhe
 - 5) deklaratat e palëve, dëshmitarët dhe ekspertët, të cilët marrin pjesë në shqyrtimin me gojë, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me rrjedhën e procedurës.

Shqyrtimi me gojë

Neni 12

- (1) Nëse në bazë të ankesës si dhe dëshmive dhe dokumentacionit bashkëngjithës ndaj ankesës, komisioni përcakton se nuk mund të përcaktohet plotësisht gjendja faktike, komisioni mund të vendosë të mbajë seancë, ku do të mbahet shqyrtim me gojë për nxjerrjen e dëshmive, respektivisht për shqyrtim me gojë për lëndën e kontestit, me ç'rast i thirr palët në procedurë për pjesëmarrje.
- (2) Në seancën e komisionit, ku mbahet shqyrtimi me gojë në lidhje me ankesën e parashtruar, kryetari dhe anëtarët e komisionit mund të parashtrojnë pyetje në lidhje me qyrtësimin e aludimeve në dëshmitë e parashtruara, ndërsa palët në procedurë deklarohen, respektivisht japin mendimet dhe propozimet e tyre sipas dëshmive të dërguara.
- (3) Komisioni Rregullator i Energjetikës mundet që me propozim nga komisioni, në seancën e komisionit, ku bëhet shqyrtimi me gojë, të thirrë edhe përfaqësuesit e autorizuar të organeve shtetërore, institucionet publike, shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet publike, nëse vlerëson se ato subjekte kanë dëshmi ose njohuri me rëndësi qenësore për vendimarrje sipas ankesës, ose përmes dhënies së qëndrimeve dhe të mendimeve të tyre mund të kontribuojnë për përcaktimin e gjendjes faktike.
- (4) Për shqyrtimin me gojë bëhet procesverbal.

Ekspertët

Neni 13

- (1) Komisioni Rregullator i Energjetikës, me propozim nga komisioni ose nga pala në procedurë, mund të emërojë një ose më shumë persona, të cilët kanë licencë për ekspertizë nga radhët e ekspertëve të regjistruar në Regjistrin e Ekspertëve.
- (2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse shpenzimet për ekspertizën që duhet të bëhet me kërkesë të komisionit, janë disproporcionalisht të larta, sipas rëndësisë ose vlerës së lëndës, sipas ankesës vendos në bazë të mjeteve të tjera të dëshmuara.
- (3) Eksperti i parashtron gjetjet për faktet dhe mendimet për çështje të caktuara në lidhje me ankesën, të cilat i përcakton Komisioni Rregullator i Energjetikës ose pala në procedurë.
- (4) Me kërkesë nga komisioni ose nga pala, eksperti pas parashtrimit të gjetjes dhe/ose të mendimit, merr pjesë në seancën e komisionit, ku bëhet shqyrtimi me gojë dhe i përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e komisionit ose palët në lidhje me aludimet e përmbajtura në gjetje dhe/ose mendim.
- (5) Shpenzimet për ekspertin përcaktohen sipas shumës së lëndës së kontestit dhe për shpenzimet e bëra reale në lidhje me punën e tij në përputhje me rregullin, me të cilin përcaktohet shpërblimi për ekspertët.

Shpenzimet e procedurës

Neni 14

- (1) Palët në procedurë për vendimmarrje sipas ankesave vetë i bartin shpenzimet e shkaktuara me veprimet e tyre.
- (2) Shpenzimet për punën e komisionit në procedurë, përfshirë edhe ekspertizën me propozim nga komisioni, i bart Komisioni Rregullator i Energjetikës.

Barazimi

Neni 15

- (1) Gjatë procedurës, komisioni insiston që palët të barazohen plotësisht ose vetëm të çështjet e caktuara të kontestueshme.
- (2) Në procedurën e barazimit, komisioni ka kujdes që barazimet të jenë gjithmonë të precizuara në mënyrë të qartë dhe precize dhe të mos jenë në dëm të interesit publik, ose të interesit ligjor të personave të tretë, në të kundërt, Komisioni Rregullator i Energjetikës nuk do ta lejojë barazimin dhe për këtë do të sjellë aktvendim.
- (3) Barazimi lidhet kur palët do ta nënshkruajnë procesverbalin për barazim, të cilin e përpilon komisioni.
- (4) Procesverbali për barazim përpilohet në tri kopje, nga një për secilën nga palët dhe një për Komisionin Rregullator të Energjetikës.
- (5) Barazimi ka fuqinë e aktit administrativ ekzekutiv, të sjellë në procedurë.

Sjellja e aktvendimit sipas ankesës

Neni 16

- (1) Në afat prej 50 ditësh nga dita e pranimit të aneksës, me të gjitha shkresat, komisioni përgatit propozim aktvendim sipas ankesës dhe ia dërgon Komisionit Rregullator të Energjetikës.
- (2) Komisioni Rregullator i Energjetikës e sjell aktvendimin sipas ankesës në afat prej shtatë ditësh, pas pranimit të propozim aktvendimit sipas ankesës.

- (3) Gjatë sjelljes së aktvendimit sipas ankesës, Komisioni Rregullator i Energjetikës i merr parasysht edhe deklaratat e palëve, dëshmitarët dhe ekspertët, të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin me gojë nga neni 12 i këtyre rregullave, si dhe nga gjendja e përcaktuar gjatë këqyrjes nga neni 11 paragrafi (5) i këtyre rregullave, të cekura në procesverbalët përkatës.

Fuqia ligjore e aktvendimit, mjetet juridike dhe publikimi i aktvendimit

Neni 17

- (1) Aktvendimi sipas ankesës hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij.
- (2) Nga një kopje e aktvendimit sipas ankesës iu dërgohet edhe palëve në procedurë.
- (3) Aktvendimi sipas ankesës është final dhe nuk mund të nisest kontest administrativ kundër tij. Nisja e kontestit administrativ nuk e shtyen zbatimin e aktvendimit.
- (4) Komisioni Rregullator i Energjetikës e publikon aktvendimin sipas ankesës në faqen e tij të internetit në përputhje me rregullat e vlefshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

III. VEPRIMI SIPAS KONTESTEVE

Nisja e procedurës

Neni 18

Komisioni Rregullator i Energjetikës nis procedurë për zgjidhjen e kontesteve të shkaktuara nga realizimi i marrëveshjeve mes ushtruesve të veprimtarive energjetike, ushtruesve të veprimtarive energjetike dhe konsumatorëve, si dhe operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe përdoruesve të atyre sistemeve, kur për atë janë marrë vesh palët kontraktuese.

Parashtrimi i kërkesës

Neni 19

- (1) Procedura për zgjidhjen e kontesteve nga neni 18 të këtyre rregullave nis pas kërkesës së parashtruar për vendimmarrje sipas kontestit, të parashtruar nga palët në marrëveshje (në vazhdim të tekstit: kërkesë), të cilat janë palë në procedurën për zgjidhjen e kontestit.
- (2) Kërkesa përmban posaçërisht:
 - 1) Të dhënat për parashtruesin e kërkesës, përfshirë edhe të dhënat për kontakt,
 - 2) Kopje nga marrëveshja ose kontrata, nga e cila mund të përcaktohet se palët kontraktuese janë pajtuar që kontesti të zgjidhet nga Komisioni Rregullator i Energjetikës, në përputhje me këto rregulla,
 - 3) Përshkrimin e kontestit dhe i gjendjes faktike, si dhe baza ligjore, në të cilën është bazuar kërkesa dhe dokumentet dhe dëshmitë e tjera, të cilat parshtruesi e bazon kërkesën dhe
 - 4) Kërkesën për mbajtjen e shqyrtimit me gojë.
- (3) Kërkesa dhe dëshmitë dhe dokumentacioni bashkëngjites, dërgohen në tri kopje, prej të cilëve dy për Komisionin Rregullator të Energjetikës, ndërsa një për palën, kundër të cilës nisest kontesti.
- (4) Kërkesa parashtrohet në afat prej 60 ditëve nga dita kur ka ndodhur kontesti, në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës, përmes postës së rekomanduar ose përmes postës elektronike.

- (5) Nëse kërkesa parashtrohet në formë elektronike, dokumentacioni bashkëngjitur dërgohet në formë të skanuar.
- (6) Dita e pranimit të kërkesës është:
 - dita kur është dërguar kërkesa deri te arkivi i Komisionit Rregullator të Energjetikës, ose
 - dita e shënuar në dërgesën e rekomanduar.

Puna e komisionit Neni 20

- (1) Sipas kërkesës së parashtruar vepron komisioni nga neni 8 i këtyre rregullave.
- (2) Komisioni e shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin bashkëngjitur dhe nëse përcakton se është e paplotë, e detyron parashtruesin që ta rregullojë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.
- (3) Nëse parashtruesi në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e rregullon kërkesën, komisioni i propozon Komisionit Rregullator të Energjetikës që me aktvendim ta hedhë poshtë kërkesën.

Vendimmarrja për autorizim sipas kontestit Neni 21

- (1) Komisioni Rregullator i Energjetikës, me propozim të komisionit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së rregullt, sjell aktvendim, me të cilin deklarohet nëse kontesti mund të zgjidhet në suaza të Komisionit Rregullator të Energjetikës, respektivisht nëse është i autorizuar për vendimmarrje sipas kontestit.
- (2) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni i dërgohet parashtruesit.
- (3) Në rastin kur Komisioni Rregullator i Energjetikës sjell aktvendim, me të cilin deklarohet si i paautorizuar për veprim sipas kërkesës për vendimmarrje sipas kontestit, palët në kontest, mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në procedurë gjyqësore ose në ndonjë tjetër procedurë.

Dërgimi i kërkesës deri te pala, kundër të cilës nisët kontesti Neni 22

- (1) Nëse në përputhje me nenin 21 paragrafi (1) të këtyre rregullave, Komisioni Rregullator i Energjetikës deklarohet si i autorizuar për zgjidhjen e kontestit, në afat prej tri ditëve të punës, komisioni ia dërgon kërkesën palës, kundër të cilës nisët kontesti, që me kërkesë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të parashtrës së përgjigje ndaj kërkesës.
- (2) Përgjigja ndaj kërkesës duhet të përmbajë:
 - 1) Deklarimin në lidhje me kërkesën e palës, e cila e nis kontestin, gjendjen faktike dhe bazën ligjore, në të cilën e bazon përgjigjen e tij,
 - 2) Dokumentet dhe dëshmitë, me të cilat vërtetohen aludimet në deklarin nga pika 1) e këtij paragrafi dhe
 - 3) Deklarimin sipas kërkesës për mbajtjen e shqyrtimit me gojë.
- (3) Pala, kundër të cilës nisët kontesti, e dërgon përgjigjen e kërkesës njëkohësisht deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe te parashtruesi.

Veprimi sipas kërkesës dhe plotësimi i tij

Neni 23

Kërkesa dhe përgjigja ndaj kërkesës mund të ndryshohet dhe të plotësohet nga palët në kontest gjatë procedurës, me përjashtim të rastit kur Komisioni Rregullator i Energjetikës vlerëson se nuk sjell rezultat dhe se e zgjat procedurën.

Pagesa e shpenzimeve me avancë

Neni 24

- (1) Komisioni Rregullator i Energjetikës sjell vendim, me të cilin e përcakton shumën, të cilën palët në kontest duhet ta paguajnë si avancë për shpenzimet për procedurën në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.
- (2) Shuma e avancës për shpenzimet e procedurës duhet të jetë përkatëse me shumën e paraparë të shpenzimeve të përcaktuara në përputhje me nenin 29 të këtyre rregullave dhe paguhet në llogarinë e Komisionit Rregullator të Energjetikës, me ç'rast secila palë e paguan gjysmën e shumës.
- (3) Në rast se gjatë procedurës, avanca e paguar nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet materiale, Komisioni Rregullator i Energjetikës mund të vendos që palët të paguajnë avancë shtesë.
- (4) Në rast se njëra prej palëve në kontest, në afatin e paraparë nuk e paguan avancën ose avancën shtesë, Komisioni Rregullator i Energjetikës do të kërkojë nga pala tjetër që ta kryejë atë pagesë në afatin e përcaktuar, ndërsa nëse pala tjetër nuk e kryen pagesën e kërkuar, Komisioni Rregullator i Energjetikës sjell vendim për ndërprerjen e procedurës në afat prej 15 ditësh nga dita e skadimit të afatit për kryerjen e pagesës.
- (5) Nëse njëra palë e ka kryer pagesën e avancës në vend të palës tjetër, me kërkesë të palës që e ka paguar avancën, Komisioni Rregullator i Energjetikës sjell vendim, me të cilin e detyron palën tjetër që ta kompensojë avancën e paguar në emrin e saj.
- (6) Pas kryerjes së procedurës, pjesa e papërdorur e avancës iu kthehet palëve në kontest.

Nxjerrja e dëshmime

Neni 25

- (1) Komisioni vendos se cilat dëshmi duhet të nxirren për të përcaktuar gjendjen faktike dhe cilat kanë rëndësi për sjelljen e aktvendimit në një kontest.
- (2) Palët në kontest janë të detyruara të bashkëpunojnë për nxjerrjen e dëshmime dhe t'i kryejnë të gjitha veprimet, që i kërkon komisioni nga ato.
- (3) Komisioni do t'i mbledhë të gjitha informatat, dokumentet dhe dëshmitë e tjera të nevojshme, që i posedon një organ tjetër apo ushtrues i veprimtarisë energjetike, të cilat palët nuk mund t'i sigurojnë, ndërsa të cilat janë të nevojshme për sjelljen e aktvendimit në kontest.
- (4) Nëse pala në kontest, e cila është thirrur nga komisioni për të dërguar dokumente dhe dëshmi të tjera, nuk i dërgon dëshmitë dhe dokumentet e kërkuara, komisioni sjell vendim në bazë të dëshmime dhe dokumenteve që i ka në dispozicion.
- (5) Pala mund të parashtrijë kërkesë për nxjerrjen e dëshmisë, me ç'rast do ta kompensojë shpenzimin për nxjerrjen e dëshmisë, të përcaktuar nga komisioni sipas shpenzimeve reale për nxjerrjen e dëshmisë.
- (6) Me përfundim, komisioni do ta hedhë poshtë kërkesën nga paragrafi (5), të këtij neni nëse kompensimi i shpenzimit nuk është paguar në afatin e përcaktuar nga komisioni.

Shqyrtimi me gojë

Neni 26

- (1) Gjatë procedurës, komisioni mundet që me kërkesë të palës në kontest, të organizojë shqyrtim me gojë, ku do të dëgjohen palët, do të nxirren dëshmi dhe do të dëgjohen dëshmitarët.
- (2) Komisioni nuk do të organizojë shqyrtim me gojë nëse njëra prej palëve kërkon mbajtjen e shqyrtimit me gojë, ndërsa të dyja palët janë deklaruar paraprakisht se nuk do të kërkojnë shqyrtim me gojë.
- (3) Në rastin nga paragrafi (2) të këtij neni, komisioni vendos në bazë të dëshmive dhe të dokumentacionit që e ka në dispozicion.
- (4) Me kërkesë të palës në kontest, komisioni mund ta shtyjë mbajtjen e shqyrtimit me gojë për një periudhë jo më të gjatë se 15 ditë nga dita kur është dashur të mbahet, nëse vlerëson se është e arsyetueshme dhe nuk do ta zvarrisë procedurën.
- (5) Në fillimin e debatit publik, parashtuesi i nxjerr dëshmitë, të cilat e bazon kërkesën dhe i shpjegon arsyet për nisjen e procedurës, ndërsa palës tjetër i jepet mundësia që të deklarohet për të gjitha rrethanat dhe që t'i nxjerrë të gjitha dëshmitë mbi të cilat bazohet përgjigja.
- (6) Gjatë shqyrtimit me gojë, të dyja palët në procedurë kanë të drejtë të propozojnë dëshmitarë dhe dëshmi, të cilat vlerësojnë se janë të rëndësishme për zgjidhjen e procedurës.
- (7) Njoftimet për dëshmitarët që duhet të thirren për të dëshmuar, i dërgohen palës tjetër dhe komisionit, në afat prej pesë ditëve të punës para ditës së mbajtjes së shqyrtimit me gojë.
- (8) Komisioni e mban shqyrtimin me gojë edhe pa prezencën e palës, e cila është thirrur në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë personalisht ose përmes përfaqësuesit të saj ligjor.
- (9) Nëse në seancë, ku dëgjohen palët, nuk merr pjesë parashtuesi dhe nuk e arsyeton mosprezencën e tij, do të merret parasysh se kërkesa është tërhequr, me ç'rast komisioni përgatit propozim-aktvendim në përputhje me nenin 28.
- (10) Për shqyrtimin me gojë, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit, nga sekretari dhe nga palët, respektivisht nga përfaqësuesit e tyre.
- (11) Refuzimi i palës për ta nënshkruar procesverbalin, vendoset në procesverbal, bashkë me arsyet për refuzim, të cilat komisioni i ka marrë parasysh gjatë sjelljes së vendimit.

Ekspertët dhe barazimi

Neni 27

Gjatë kryerjes së procedurës për zgjidhjen e kontesteve, sa i përket çështjeve për përdorimin e ekspertëve dhe për kryerjen e barazimit, Komisioni i zbaton në mënyrë përkatëse dispozitat nga nenet 13 dhe 15 të këtyre rregullave.

Përfundimi i procedurës

Neni 28

- (1) Procedura për zgjidhjen e kontestit përfundon me sjelljen e aktvendimit përfundimtar, me të cilin vendoset për thelbin e kontestit ose me aktvendim për përfundimin e procedurës.
- (2) Aktvendimi për përfundimin e procedurës sillet nëse:
 - 1) njëra nga palët ka sjellë deri te komisioni njoftim se heq dorë nga procedura,
 - 2) pala nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin me gojë, ku është thirrur me rregull, ndërsa nuk e ka arsyetuar mungesën e saj, ose

- 3) palët e kanë njoftuar komisionin se janë marrë vesh për përfundimin e procedurës.
- (3) Njoftimi nga paragrafi (2) pikat 1) dhe 3) të këtij neni nuk i liron palët nga detyrimi për t'i paguar shpenzimet nga procedura dhe nuk ua mundëson të drejtën për kthimin e shpenzimeve që i kanë paguar deri në ditën e dërgimit të njoftimit.
- (4) Në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e plotësimit të kushteve nga pikat 1), 2) dhe 3) të paragrafit (2) të këtij neni, komisioni i propozon Komisionit Rregullator të Energjetikës të sjellë vendim për përfundimin e procedurës.
- (5) Komisioni Rregullator i Energjetikës sjell aktvendim për përfundimin e procedurës në afat prej 7 ditëve.

Shpenzimet e procedurës

Neni 29

- (1) Me aktvendim të sjellë me propozim të komisionit, Komisioni Rregullator i Energjetikës e përcakton shumën e shpenzimeve të procedurës, të cilën palët duhet ta paguajnë.
- (2) Nëse me marrëveshjen palët nuk janë marrë vesh për mënyrën e rregullimit të shpenzimeve në procedurë, atëherë mënyrën e përcakton komisioni me propozimin nga paragrafi (1) i këtij neni me vlerësim të lirë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, posaçërisht rezultatin e procedurës.
- (3) Shpenzimet për procedurën shprehen në denarë.
- (4) Shpenzimet e procedurës përbëhen nga:
 - 1) shpenzime materiale për nxjerrjen e dëshmive, të cilat përcaktohen në shumën e shpenzimeve të bëra reale,
 - 2) shumën dhe shpërblimin për ekspertizën, të përcaktuara në përputhje me dispozitën, me të cilën rregullohet mënyra për përcaktimin e shpërblimit dhe të kompensimit për ekspertizë dhe
 - 3) shpenzimet për përfaqësim.

Sjellja e aktvendimit sipas kontestit

Neni 30

- (1) Në afat prej 15 ditësh nga dita e mbarimit të veprimit të fundit procedural në procedurë, komisioni përgatit propozim aktvendim sipas kontestit, me të cilin vendoset për thelbin e kontestit, të cilin ia dërgon Komisionit Rregullator të Energjetikës.
- (2) Komisioni Rregullator i Energjetikës e sjell aktvendimin sipas kontestit në afat prej shtatë ditësh, pas pranimit të propozim aktvendimit.
- (3) Gjatë sjelljes së aktvendimit sipas kontestit, Komisioni Rregullator i Energjetikës e merr parasysh dokumentacionin e plotë të lëndës sipas kontestit.
- (4) Aktvendimi nga paragrafi (2) i këtij neni sa i përket palëve, ka fuqi ligjore nga dita e dërgimit të tij deri te palët në përputhje me nenin 31 paragrafi (4) të këtyre rregullave.

Forma, përmbajtja dhe dërgimi i aktvendimit sipas kontestit

Neni 31

- (1) Aktvendimi sipas kontestit sillet në formë të shkruar dhe përmban:

- 1) hyrjen, e cila përmban: emrin e komisionit, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe të anëtarëve të komisionit, emrin dhe selinë e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, shënimin e shkurt të lëndës së kontestit dhe ditën e sjelljes së aktvendimit,
 - 2) thënien, në të cilën në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë përmbahet vendimi i komisionit për kërkesën,
 - 3) arsyetimin, ku komisioni i nxjerr: kërkesat e palëve dhe aludimet e tyre për dëshmitë, mbi të cilat themelohen ato kërkesa, dëshmitë, dëshmitë zgjidhëse që i ka përcaktuar, si dhe dispozitat, në bazë të të cilave komisioni e ka themeluar vendimin.
- (2) Në aktvendimin nga paragrafi (1) të këtij neni theksohet edhe shuma dhe shpërndarja e shpenzimeve, si dhe mënyra e pagesës së tyre.
 - (3) Pas sjelljes së aktvendimit nga neni 30 paragrafi (2) të këtyre rregullave, secilës prej palëve iu sillen nga një kopje.
 - (4) Nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, Komisioni Rregullator i Energjetikës ua dërgon palëve aktvendimin nga neni 30 paragrafi (2) i këtyre rregullave, me postë të rekomanduar.
 - (5) Nëse pajtohen palët, aktvendimi nga neni 30 paragrafi (2) i këtyre rregullave publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës në përputhje me rregullat e vlefshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmirësimi i aktvendimit sipas kontestit

Neni 32

- (1) Nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga neni 30 paragrafi (2) i këtyre rregullave, secila palë, me njoftim deri te pala tjetër mund të kërkojë nga komisioni përmirësimin e gabimit përlogaritës, të shkruar, të shtypur ose të ndonjë gabimi tjetër me natyrë të ngjashme në aktvendim,
- (2) Nëse komisioni vlerëson se kërkesa është e arsyetuar, do ta përmirësojë aktvendimin.
- (3) Komisioni mund ta përmirësojë secilin gabim të cekur në paragrafin (1) të këtij neni me iniciativë personale në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes së aktvendimit.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Dispozitat kalimtare

Neni 33

Procedurat për vendimmarrje sipas ankesave dhe kontesteve, të cilat janë në vijim, do të vazhdojnë të udhëhiqen në përputhje me dispozitat e këtyre rregullave.

Dispozitat përfundimtare

Neni 34

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, nuk do të vlejnjë më Rregullat për Veprim sipas Ankesave dhe për Zgjidhjen e Kontesteve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 132/23).

Neni 35

Këto rregulla hyjnë në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit të tyre në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**Nr. 01-2559/1
4 dhjetor 2023
Shkup**

**Zëvendëskryetari
i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe,
i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me
Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut
Lirim Sulejmani**